



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. 01-1333/14
Dep. Dep. 02	Br Prot. Prot No
Nr. i faq. 02	Data 14.04.2014
Straj. stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4231/13, për z. Ismail Osdautaj – Antar i Bordit në Agjencinë Kosovare të Pronës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ismail Osdautaj – Antar i Bordit në Agjencinë Kosovare të Pronës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private D.P.H “Blini”, Agjencion për Shërbime Juridike “Blendi”, N.Sh. “Mjeku Juaj”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Osdautaj është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, Pas pranimin të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Osdautaj ka deklaruar se bizneset janë pasive, prandaj ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Zyrtari i lartë z. Osdautaj, ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03- 1201/14)(DPKI 03-1200/14)(DPKI 03-1199) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja vullnetare e bizneseve private.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

